



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 3 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 80-të të mbajtur më 18.01.2023 ka miratuar si në vijim.

#### VENDIM

Procedura me nr. 12-6523/1, datë 28.06.2022, e formuar pas denoncimit të dorëzuar për ndërtim, pa leje ndërtimi të siguar, **NDËRPRITET**.

KSHPK-ja konstatoi nuk ka elemente për veprime të mëtejshme lidhur me lëndën, për rastin në fjalë procedurat janë duke vazhduar para organeve tjera kompetente ose tashmë kanë vepruar autoritetet tjera kompetente.

Lënda me numër 12-6523/1 të datës 28.06.2022 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb-faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

#### Arsyetim

Më datë 28.06.2022, është dorëzuar denoncim nga një parashtrues i njohur për ndërtimin e një shtëpie familjare në Komunën ----- pa leje të rregullt ndërtimi dhe është formuar lënda me numër 12-6523/1 të datës 28.06. .2022.

Pretendimet në denoncim, parashtruesi thekson se një person fizik po ndërton objekt pa leje në adresën "-----" ---- në Komunën ----- pa lejen e duhur të ndërtimit të siguar, e cila tashmë është ndërtuar në fazën e karabinës. Kërkuesi deklaron se është parcelë ngjitur me të tijën dhe se ndërtimi ka devijuar nga vula e paraparë, pas së cilës kërkon që KSHPK-ja të veprojë në përputhje me kompetencat e saj ligjore. parashtruesi po ashtu në denoncim thekson se të njëjtin i është drejtuar tashmë me një peticion në Komunë -----.

Me qëllim të verifikimit të pretendimeve dhe përcaktimit të gjendjes faktike në rastin e denoncuar, KSHPK-ja i ka dorëzuar Komunës kërkesë për mbledhjen e informacionit -----

-- me qëllim të dhënies së informacionit nëse komuna tashmë ka vepruar për pretendimet në fjalë si dhe për rezultatin e procedurës kompetente.

Në afatin e përcaktuar ligjor, në kërkesën e parashtruar është pranuar përgjigje në të cilën thuhet se është kryer kontroll në vendngjarje nga Inspektori i Autorizuar i Ndërtimit në Komunën ----- - pas asaj që është konstatuar se personi i treguar në denoncim është duke ndërtuar një objekt banimi për të cilin nuk ka pasur leje ndërtimi. Për këtë arsye është nisur një procedurë inspektimi dhe është marrë vendim për heqjen e objektit.

për të konstatuarën tashmë i është dërguar njoftim parashtruesit për gjetjet si përgjigje ndaj petitionit të dorëzuar.

Nga sa më sipër, KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprime të metutjeshme sipas lëndës, për lëndën në fjalë procedurat janë duke u zhvilluar para organeve tjera kompetente apo tashmë kanë vepruar dhe vendosur organet tjera kompetente si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar deri:

Parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: Mr K.Z

Miraturar: Mr.Sh. S.

KOMISIONI SHTETËRORE  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT

Nënkryetar  
Mr. Vlladimir Georgiev

---